REPUBLIKA E SHQIPERISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

DOKUMENTAT STANDARDE TË PROCEDURËS SË HAPUR SHËRBIME

SHËRBIM MIRËMBAJTJE DHE LYERJE NDËRTESASH
9 (nëntë) lote

– Marreveshje Kuader –

I . NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa	Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.
Tel/Fax	+355 42 247 865
E-mail	Denisa.Rakipaj@mb.gov.al Anisa.Bogdani@mb.gov.al Marsidi.Gupi@mb.gov.al
Faqja në Internet	www.mb.gov.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qëndror	Institucion i pavarur
X	
Njësi e qeverisjes vendore	Tjetër

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po Jo **X**

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81803-08-02-2018

2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Shërbime"

Konkurs Projektimi	**Shërbime Konsulence**	**Shërbime të tjera**
		X

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po **X** Jo

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë X

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po X Jo

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër: disa operatore ekonomike (1 operator *per secilin lot*).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike	**Nuk do të ketë rihapje të konkursit.** **Kontratat do të lidhen sipas kerkesave te Autoriteteve Kontraktore të përcaktuara në pikën 2.7 të DST-ve, me operatorin ekonomik të suksesshëm.** **Dhënia e kontratave do të behet nga Autoritetet Kontraktore të përcaktuara në pikën 2.7 të DST-ve.** Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje. Ne rast te lindjes se nevojes konkrete per te lidhur nje kontrate brenda marrëveshjes kuader, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë "ftesën për ofertë" tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasitë përkatëse. Autoriteti kontraktor i kerkon operatorit ekonomik, fitues te japë oferten e tij. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar, ose elektronike (email, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures. Sherbimet e parashikuara dhe të

		kerkuara janë vetëm orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i berë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kerkoje më pak apo më shumë sherbime se sa ato te parashikuara. (por ne cdo rast brenda vleres se perllogaritur te marreveshjes kuader). Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të kerkoje më pak apo më shumë sherbime se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos kerkoje asnjë nga këto sherbime për disa zera. Çmimet për njësi janë percaktuar në Formularin e Cmimit të Ofertës. Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

2.7 Autoriteti kontraktor / Autoritetet kontraktore, të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në emër dhe për llogari të autoriteteve kontraktore si më poshtë:

1. Spitali Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan
2. Spitali Rajonal Berat
3. Spitali Rajonal Lezhë
4. Spitali Rajonal Fier
5. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
7. Spitali Rajonal Durrës
8. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale te Shtetit(Ministria e Mbrojtjes)
9. Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

2.8 Përshkrim i shkurtër marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit: 31,571,832 (tridhjetë e një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH
2. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit
3. Objekti i marrëveshjes kuadër **: Shërbim mirëmbajtje dhe lyerje ndërtesash**

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në **muaj ose ditë**

ose

- Loti I. "Shërbim mirëmbajtje për Spitalin Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti II. "Shërbim i lyerjeve dhe mirëmbajtje për Spitalin Rajonal Berat" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti III. "Shërbim i mirëmbajtje për Spitalin Rajonal Lezhë" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti IV. "Shërbim i lyerjeve për Spitalin Rajonal Fier, për godinën e poliklinikës Fier dhe godinën e pediatrisë" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti V. "Shërbim i mirëmbajtjes ndërtesash MBZHRN-në" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti VI. "Shërbim i mirëmbajtje për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti VII. "Shërbim lyerje ndërtesash për Spitalin Rajonal Durrës" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti VIII. "Shërbim mirëmbajtje ndërtimore e ndërtesës së Ministrisë së Mbrojtjes" **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

- Loti IX. “Lyerje dhe shërbim mirëmbajtje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër .
Ose **duke filluar nga** // **(dd/mm/vvvv)** **Përfunduar më** // **(dd/mm/vvvv)**

2.10 Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:

1. Spitali Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan
2. Spitali Rajonal Berat
3. Spitali Rajonal Lezhë
4. Spitali Rajonal Fier
5. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
7. Spitali Rajonal Durrës
8. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale te Shtetit(Ministria e Mbrojtjes)
9. Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

2.11 Ndarja në Lote:

Po **X** Jo

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i loteve)

- Loti I. “Shërbim mirëmbajtje për Spitalin Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan” me fond limit 5 498 177 lekë pa Tvsh.

- Loti II. “Shërbim i lyerjeve dhe mirëmbajtje për Spitalin Rajonal Berat” me fond limit 2 266 666 lekë pa Tvsh.

- Loti III. “Shërbim i mirëmbajtje për Spitalin Rajonal Lezhë” me fond limit 1 250 000 lekë pa Tvsh.

- Loti IV. “Shërbim i lyerjeve për Spitalin Rajonal Fier, për godinën e poliklinikës Fier dhe godinën e pediatrisë” me fond limit 2 684 526lekë pa Tvsh.

- Loti V. “Shërbim i mirëmbajtjes ndërtesash MBZHRN-në” me fond limit 4 992 110 lekë pa Tvsh.

- Loti VI. “Shërbim i mirëmbajtje për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” me fond limit 1 816 722 lekë pa TVSH.

- Loti VII. “Shërbim lyerje ndërtesash për Spitalin Rajonal Durrës” me fond limit 3 788 660 lekë pa TVSH.

- Loti VIII. “Shërbim mirëmbajtje ndërtimore e ndërtesës së Ministrisë së Mbrojtjes” me fond limit 1 250 000 lekë pa TVSH.

- Loti IX. “Lyerje dhe shërbim mirëmbajtje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit” me fond limit 8 024 971 lekë pa TVSH.

Një Ofertues mund të aplikojë ne disa lote , Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme *(nëse ka)*:

Ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Po Jo

2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po Jo **X**

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: ____

Autoriteti kontraktor do t’i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po Jo

Shenime te tjera

_____
_____
_____
_____

2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit:

Po Jo **X**

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo **X**

Seksioni 3 **Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës 8

3.2 Sigurimi i Ofertës[1]: nuk kërkohet
(i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor**)** Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, **sipas Shtojcës 3**. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, për secilin nga Lotet është si më poshtë:
Loti 1 _____ Lekë
Loti 2 _____ Lekë

Seksioni 4 **Procedura**

4.1 Lloji i procedurës: E hapur

Procedurë prokurimi e rishpallur
Po Jo **X**

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anulluar
_____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anulluar _____

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anulluar _____

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
A) **çmimi më i ulët për secilin Lot** X
Ose

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme**

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**

etj. **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **27/08/2018 Ora: 11:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **27/08/2018 Ora: 11:00**

Vendi: Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Informacioni mbi ofertate paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 *(e shprehur në ditë)*

4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip **X** Anglisht

Tjetër _____

Seksioni 5 **Informacione plotësuese**

5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po Jo **X**

Nëse Po

Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Vendi: Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **03/08/2018**

Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa	Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.
Tel/Fax	+355 42 247 865
E-mail	Denisa.Rakipaj@mb.gov.al
	Anisa.Bogdani@mb.gov.al
	Marsidi.Gupi@mb.gov.al
Faqja në Internet	www.mb.gov.al

2. Lloji i procedurës se prokurimit: Procedure e Hapur, Marrëveshjes kuadër, me disa operatore ekonomike ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj.

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Shërbim mirëmbajtje dhe lyerje ndërtesash

4.Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-81803-08-02-2018**

Loti 1 Spitali Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan **REF-81806-08-02-2018**

Loti 2 Spitali Rajonal Berat **REF-81808-08-02-2018**

Loti 3 Spitali Rajonal Lezhë **REF-81810-08-02-2018**

Loti 4 Spitali Rajonal Fier **REF-81812-08-02-2018**

Loti 5 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural **REF-81814-08-02-2018**

Loti 6 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **REF-81816-08-02-2018**

Loti 7 Spitali Rajonal Durrës **REF-81819-08-02-2018**

Loti 8 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale te Shtetit(Ministria e Mbrojtjes) **REF-81821-08-02-2018**

Loti 9 Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit **REF-81823-08-02-2018**

5. Fondi limit 31,571,832 (tridhjetë e një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) leke pa tvsh

6. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër: **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër 12 muaj**.

7- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

27/08/2018 Ora: 11:00

8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

27/08/2018 Ora: 11:00

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1. Hartimi i ofertës

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertes duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.

1.5 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formulari i Ofertës Ekonomike, plotësuar **sipas Shtojcës 1 të DT.**

b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
_____ ,
_____ ,
_____ .

c) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara **në Shtojcën 7**

ç) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

1.6 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

1.7 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për kryerjen e _____shërbimeve; Nr e Njoftimit _____ **"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA _____ (dd/mm/vv) orës _____".**

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **"MODIFIKIM OFERTE"** ose **"TËRHEQJE OFERTE".**

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund te modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

Seksioni 2 <u>Përllogaritja e ofertës ekonomike</u>

2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të ekzekutohen dhe çmimin e tyre.

2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.

2.4. Në rastin e nje marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkurrimi midis operatorëve ekonomikë, palë në marreveshjen kuadër.

2.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.6 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare
b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.7 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, *të paktën 5 ditë nga përpara* përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

2.8 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

Seksioni 3. <u>Vlerësimi i ofertave</u>

3.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:
Po - jane pikët totale të ofertës së vlerësuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____	Pikët e kriterit që vlerësohet
Vmin k1	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
Pmaxk1	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
Ok1	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim
Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

Në rastin e prokurimit të marrëveshjes kuadër, kur objekt i kësaj marrëveshje janë biletat e transportit ajror ndërkombëtar, në vend të çmimit do të përdoret marzhi i fitimit i shprehur në përqindje.

3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe

rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

3.3 Ofertat anomalisht të ulëta

3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me shërbimet e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
M_O – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
n – Numri i Ofertave të vlefshme
Z_M – Zbritja e Mundshme

$$\mathbf{M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \ldots O_n / n}$$

$$\mathbf{Z_M = 85\ \%\ Mo}$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM..... , <u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme,

do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.3.3 Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Seksioni 4. Nënshkrimi i kontratës

4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në **Shtojcën 14.** Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas **Shtojcës 20 të DT**, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

i. garanci bankare,
ii. garanci sigurimi,

Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

4.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Shënim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë (në rastin e Marrëveshjes Kuadër)
Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial
Shtojca 5: Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik
Shtojca 6: Deklaratë për konfliktin e interesit
Shtojca 7: Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve te pergjithshme
Shtojca 8: Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit
Shtojca 9: Specifikimet teknike
Shtojca 10: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
Shtojca 11: Sherbimet dhe Grafiku i ekzekutimit
Shtojca 12: Termat e Referencës
Shtojca 13. Formulari për Njoftimin e Skualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca 15: Formulari i Njoftimit te operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
Shtojca 16: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Shtojca 17: Kushtet e Veçanta të Kontratës
Shtojca 18: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar
Shtojca 19: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
Shtojca 20: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 21: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor
Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 23: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 24: Formulari i Njoftimit të Anullimit

Shtojca 1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit_____

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH

1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Nr	**Përshkrimi i Shërbimeve**	**Sasia**	**Çmimi Njësi**	**Çmimi Total**	**Afati**
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim:
Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____(e kerkuar ne dokumentat e tenderit)

Shtojca 2
[*Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*]

FTESA PËR OFERTË

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)
fton për të paraqitur oferta në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:
……
……
……
……
(*jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasise siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT)*.

Vendi i kryerjes së shërbimit
(jepni një përshkrim të shkurtër)

Kohëzgjatja e shërbimit _____

Oferta duhet të paraqitet
……
……[*Jep adresën e saktë*]
Përpara
……
…
[*Përcaktoni datën dhe orën përfundimtare*]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

Forma e komunikimit:

Me shkrim __ Elektronik (email, fax etj.) _____

Shtojca 3

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]
[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor

e kerkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti*]

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjstruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet

me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Shtojca 5

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor_____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____,me cilësinë e _____ të personit juridik _____deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

V ula

Shtojca 6

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor_____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat,Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i

barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

_____

Vula

Shtojca 7

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____me cilesinë _____të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi

vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

Loti I "Shërbim mirëmbajtje për Spitalin Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan" me fond limit 5 498 177 lekë pa Tvsh.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit,

në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimi i ofertes, (**nuk kerkohet**) sipas Shtojcës 3;
b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
ç. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;
d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Ky kriter plotesohet me kriteret e pergjithshme per kualifikim.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Xhiroja mesatare vjetore gjatë dy viteve të fundit (2016, 2017), te ketë një vlere sa 40 % e fondit limit të ketij loti. Për plotësimin e këtij kriteri ofertuesi duhet të paraqesë Vërtetimin përkatës lëshuar nga Administrata Tatimore / Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit të gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2016, 2017 të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse.

3.3 Kapaciteti teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej 40 % të vlerës së fondit limit te ketij loti.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat.

2. Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij specialiste sipas profesioneve si me poshte, për të cilët duhet të paraqesë deshmi/ certifikate/ cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tyre, ***si dhe të shoqëruar me*** *Kontratë Pune* ***dhe*** *Librezë Pune*
   - Elektricist 2(dy)
   - Hidraulik 2(dy)

3. Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij specialiste sipas profesioneve si me poshte, për të cilët duhet të paraqesë deshmi/ certifikate/ cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tyre ose eksperience pune minimalisht 3 vjet ***si dhe të shoqëruar me*** *Kontratë Pune* ***dhe*** *Librezë Pune*
   - Murator 1 (nje)
   - Specialist per punime druri 1(nje)
   - Specialist per punime duralumini 1(nje)

4. Operatori ekonomik duhet te kete të punësuar per periudhen (qershor 2017- qershor 2018) te pakten **15 punonjës** (perfshire edhe specialistet), për të cilët duhet të paraqesë:

   - *Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore leshuar nga administrata tatimore.*
   - *Listepagesat per periudhen* qershor 2017- qershor 2018 .

5. **Ofertuesi duhet te paraqesë Liçenca profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve që kërkohen të prokurohen:**

   - Punime germimi ne toke **N.P.1, -Klasifikim 'A'.**
   - Rikonstruksion dhe mirembajtje godina civile dhe industriale, veshje fasada **N.P.3, -Klasifikim 'A'.**
   - Punime per prishjen e ndertimeve **N.S.1, -Klasifikim 'A'.**
   - Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre **N.S.2, -Klasifikim 'A'.**
   - Impjante te brendshme elektrike,telefoni,radiotelefoni TV etj **N.S.14, -Klasifikim 'A'.**
   - Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj. **N.S.4, -Klasifikim 'A'.**

6. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me çertifikatat e meposhtme per objektin qe prokurohet:
   - Sistemi manaxhimit te cilesise (ISO 9001)
   - Sistemi menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001)

Çertifikata të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certefikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.

Shenim:
Operatorët ekonomikë që do të ofertojnë në më shumë se një lot, duhet të kenë xhiron dhe kontrata e ngjashme sa shuma e loteve në të cilat oferton.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Loti II "Shërbim i lyerjeve dhe mirembajtje për Spitalin Rajonal Berat" me fond limit 2,266,666 lekë pa TVSH.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime. Mostrat Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përsh tatjeve, aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për in

spektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.
Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave.
Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit.
Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të
zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si d he librezat e masave për çdovolum pune.

SEKSION 2 PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.1. Pastrimi i kantierit

2.1.1

Prishja e godinave, gardheve dhe strukturave

Kontraktori duhet të heqë me kujdes vetëm ato ndërtime, gardhe, ose struktura të tjera të drejtuara nga Supervizori. Komponentët duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj.
Komponentët të cilët sipas Supervizorit nuk janë të përshtatshëm për ripërdorim, duhen larguar, punë kjo që kryhet nga kontraktuesi. Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi ë investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvize n prej tij deri në përfundim të kontratës. Kontraktori, duhet të paguajë çdo dëmtim të bërë gja të transportit të
materialeve me vlerë, të
rrethimeve dhe struktuarave të tjera dhe nëse është e nevojshme duhet
të paguajë kompensim.

2.1.2Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto puni me prishëse. Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale.Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të
parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë,që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji.
Kur përdoren
mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatorë hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të
bëhet kujdes, qëpjesë të tyre të mos kenë kontakt me kabllo telefonik ose elektrik. Kontraktor i duhet të
informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që, ato të marrin masa për lëvizjen e kabllove.

2.1.3

Mbrojtja e vendit të pastruar

Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

2.2 PUNIME PRISHJEJE

2.2.1 Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompete nt
dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi.Kontrakt ori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigur

ojnë
stabilitetingjatë kryerjes së punës.Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar.Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës.
Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe
duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike. Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të r rugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të
makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim I objektit, si dhe veshja e të gjithë sk elerisë me rrjete mbrojtëse për të eleminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik. Skeleri çeliku të tipit këmbalëc, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport,
mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj.Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.
Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur , konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën p ër
transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

*2.2.2**Supervizioni***

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e
punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

2.2.3Metoda e prishjes
Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit. Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pje sa estrukturës që ka mbetur të
sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten. Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e
strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementë çeliku dhe struktura betoni
të forcuara do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave ne menyre qe te mos bien. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për t ë
mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të
panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për t ë
hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të transportohen nga ashensorë, pastaj do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

SEKSIONI 3 . PUNIME BETONI ARMIMI DHE HEKURI

4.1 Betoni i derdhur në vend

4.1.1 Kërkesa të përgjithshme për betonet

Betoni është një përzierje e çimentos, inerte të fraksionuara të rërës, inerte të fraksionuara të

zhavorit dhe ujit dhe solucioneve të ndryshme për fortësinë, përshkueshmërinë e ujit dhe për të bërë të mundur që të punohet edhe në temperatura të ulëta sipas kërkesave dhe nevojave teknike të projektit.

4.1.2 Materialet

•Përbërësit e Betonit

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granil, ose përzierje të të dyjave si dhe

gurë të thyer.Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dh eu.

Pjesa kryesore e agregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet të kenë çertifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato.

•Çimento

Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit

dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standarteve. Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën4.1.4, pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.

•Uji për beton

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë I pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhi min e betonit.

4.1.3Depozitimi i materialeve

Depozitimi i materialeve që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

•Çimentoja dhe përbërësit duhet të depozitohen në atë mënyrë që të ruhen nga përzierja më materiale të tjera, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe e dëmtojnë cilësinë e tij.

•Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagien e saj nga uji dhe shirat.

4.1.4 Klasifikimi i betoneve

4.1.4.1Beton marka 100, me zhavor natyror: Çimento marka 300, 240 kg;zhavorr 1,05 m³; u jë 0,19 m³.

4.1.4.*2Beton marka 100 me inerte*, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 300, 240 kg; rërë e larë 0,45 m³; granil 0,70 m³; ujë 0,19 m³.

4.1.4.3 *Beton marka 150 me inerte*, konsistencë 3 ~ 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë m e modul 2,6: Çimento marka 400, 260 kg, rërë e larë 0,44 m³, granil 0,70 m³, ujë 0,18 m³.

4.1.4.*4Beton marka 200 me inerte*, konsistencë 3 ~ 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë m e modul 2,6: Çimento marka 400, 300 kg, rërë e larë 0,43 m³, granil 0,69 m³, ujë 0,18 m³.

4.1.4.*5Beton marka 250 me inerte*, konsistencë 3 ~ 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë m e modul 2,6: Çimento marka 400, 370 kg, rërë e larë 0,43 m³, granil 0,69 m³, ujë 0,18 m³.

4.1.4.*6Beton marka 300 me inerte*, konsistencë 3 ~ 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë m

e modul 2,6: Çimento marka 400, 465 kg, rërë e larë 0,38 m³, granil 0,64 m³, ujë 0,195 m³.

4.1.5Prodhimi i betonit

Betoni duhet të përgatitet për markën e përcaktuar nga projektuesi dhe receptura e përzierjes së materialeve sipas saj në mbështetje të rregullave që jepen në KTZ 37 ~ 75 " Projektim i beto neve". -

Gjatë përgatitjes së betonit të zbatohen rregullat që jepen në kapitullin 6 "Pergatitja e betonit" të KTZ 10/1 78, paragrafët 6.2, 6.3 dhe 6.4.

4.1.6Hedhja e betonit

Hedhja e betonit të prodhuar në vend bëhet sipas mundësive dhe kushteve ku ai do të hidhet. Në përgjithësi për këtë qëllim përdoren vinçat fiks që janë ngritur në objekt si dhe autohedhëse. E rëndësishme në proçesin e hedhjes së betonit në vepër është koha nga prodhimi në hedhje, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër. Gjithashtu, një rëndësi të veçantë në hedhjen e betonit ka edhe vibrimi sa më mirë gjatë këtij proçesi.

4.1.7

Mbrojtja Betoni i freskët duhet mbrojtur nga këto ndikime:

•Shiu si dhe lagështi të tjera duke e mbuluar sipërfaqen e betonuar me plastmas dhe materiale të padepërtueshme nga uji

•Ngricat (duke i futur gjatë proçesit të prodhimit solucione kundra temperaturave të ulta mundet të betonohet deri në temperatura afër zeros.

•Temperatura të larta. Betoni mbrohet ndaj temperaturave të larta duke e lagur vazhdimisht atë me ujë, në mënyrë të tillë që të mos krijohen plasaritje.

4.1.8Betoni në kushte të vështira atmosferike

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit
në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike. Ndalohet prodhimi dhe hedhja e
betonit në rast se bie shi i rrëmbyeshëm, pasi nga sasia e madhe
e ujit që i futet betonit largohet çimentoja dhe kështu që betoni e humb markën që kërkohet.
Në rastet e temperaturave të ulta nën 4 ºC rekomandohet të mos kryhet betonimi, por n.q.s kj o
është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë proçesit të prodhimit të betonit, atij t'i shtohet solucioni ndaj ngricave
në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i këtij solucioni. Prodhimi dhe
përpunimi i betonit në temperatura të larta mund të ndikojë negativisht në reagimin kimik
të çimentos me pjesët e tjera të betonit.Për këtë arsye ai duhet ruajtur kundër temperaturave t ë
larta. Mënyra e ruajtjes nga temperatura e lartë mund të bëhet në atë mënyrë,
që betoni I freskët të mbrohet nga dielli duke e mbuluar me plasmas, tallash dhe duke e stërk atur me ujë. Një
ndihmë tjetër për përpunimin e betonit në temperatura të larta është të ngjyrosësh
mbajtësit e ujitme ngjyrë të bardhë dhe të sigurojë spërkatje të vazhdueshme me ujë.

4.1.9

Provat e betonit

Pasi është prodhuar betoni, ai duhet kontrolluar nëse i plotëson kriteret sipas kërkesave të

projektit.
Mbasi të prodhohet ai dhe para hedhjes së tij,duhet marrë një kampion betoni për të bërë testime në laborator dhe rezultatet e laboratorit duhet të dorëzohen tek Supervizori.

SEKSIONI 5 RIFINITURAT

6.1. Lyerje me bojë plastike

Lyerje me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme Proçesi i lyerjes me bojë plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet. Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me ane të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes.
Para fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e
sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Paralyerja e sipërfaqes së brendshme të pastruar -
Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg vinovil me 2.5 3 litra ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.
Norma e përdorimit është 1 litër përzierje vinovil me ujë duhet të përdoret për 20 m2 sipërfa qe.

Lyerja me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti 5 litërsh e.
Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20~30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizioni I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e
sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 45 m2 sipërfaqe. Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer. Lyerje me bojëakrelik i sipërfaqeve të jashtme .
Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare etj) me an ë të vendosjes së letrave mbrojtëse.
Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve
të pastruara mirë me vinovil të
holluar (Astar plastik). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke
bërë përzierjen e 1 kg vinovil të holluar me 3 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.
Norma e përdorimit është 1 litër vinovil i holluar qe
duhet të përdoret për 20^{m2} sipërfaqe. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë akrelik.Kjo bojë ndryshon nga boja plastike sepse ka në
përbërjen e saj vajra të ndryshme, të cilat e bëjnë bojën
rezistente ndaj rrezeve të diellit, ndaj lagështirës së shirave, etj.
Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës akrelik me ujë.Lëngu I bojës hollohet me ujë n ë
masën 20~30 %.Kësaj përzierje I hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar. Pastaj, bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë akrel ik Iholluar në 4~5 m2 sipërfaqe (në varësi te ashpërsisë së sipërfaqes së lyer).

6.2 Lyerje me bojë plastike në ndërtime të reja

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet t'i paraqesë për aprovim Supervizorit, markën , cilësinë dhe katalogun e nuancave të ngjyrave të bojës, që ai mendon të përdorë.
Të gjitha bojratqë do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë.
Nuk lejohet përzierja e dy llojevë të ndryshme markash boje gjatë proçesit të punës. Hollimi i
bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe aprovimit të Supervizorit.
Përpara fillimit të lyerjes duhet që të gjitha pajisjet, mobiljet ose objekte të tjera që ndodhen në
objekt të mbulohen në mënyrë që të mos bëhen me bojë. Është e domosdoshme, që pajisjet ose mobilje që janë të mbështetura ose të varura në mur të largohen në mënyrë që të bëhet një lyerjë komplet e objektit.
Materiali i pastrimit të njollave duhet të jetë me përmbajtje të ulët toksikimi.
Pastrimi dhe lyerja duhet të kordinohen në atë mënyrë që gjatë pastrimit të mos ngrihet pluhur
ose papastërti dhe të bjerë mbi sipërfaqen e sapolyer. Furçat, kovat dhe enët e tjera ku mbahet
boja duhet të jenë të pastra.Ato duhet të pastrohen shumë mirë përpara çdo
përdorimi sidomos kur duhet të punohet me një ngjyrë tjetër.Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në
çdo ditë.
Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet
të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ dhe STASH.

6.3Lyerja me bojë hidromat

Proçesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve kalon
nëpër trë faza si më poshtë:

1-Prëgatitja e sipërfaqes që do të lyhet

Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e bojës së
mëparshme nga sipërfaqja e lyer,
mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së
murit me anë të stukimit me
material sintetik dhe bërja gati për paralyerje .Përpara fillimit të
proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen
(dyer, dritare, etj.)
me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

2-Paralyerja e sipërfaqes së pastruar Në fillim të proçesit të lyerjes, bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqeren të
holluar (Astari).Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg gëlqere me një litër ujë.Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.
Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m2 sipërfaqe.

3-
Lyerja me bojë hidromat e sipërfaqes

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngët e cila është e paketuar në ku

ti 5-
15 litërshe.Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20~30 %. Kësaj përziërje I hidhet pigmen ti deri sa të
merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e
sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar duhet të përdoret për 2.7~3 m2
sipërfaqe.Kjo normë varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji I
bojës së mëparshme.
Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi I sipërfaqes që do
të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të
sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja
gati për lyerje. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (Astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.
Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar
duhet të përdoret për 2 m^2 sipërfaqe. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë si më poshtë:
Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngshëm me ujë. Lëngu I bojës hollohet me ujë në
masën 20~30 %.Kësaj përzierje I hidhet pigment derisa të merret ngjyra e dëshiruar.
Bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojëhidro mat I holluar në 2.7~ 3 ^{m2} sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyer)

Loti VII: "***Shërbim lyerje ndërtesash për Spitalin Rajonal Durrës***"

me fond limit **3 788 660** lekë pa TVSH.

Sipas dokumentit bashkngjitur hedhur ne sistem

Loti VIII. *"Shërbim mirëmbajtje ndërtimore e ndërtesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale te Shtetit"* me fond limit 1 250 000 lekë pa TVSH.

Tabela e përmbajtjes

SEKSION 1

SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1. Specifikime të përgjithshme

1.1.1 Njësitë matëse

1.1.2 Grafiku I punimeve

1.1.3 Punime të gabuara

1.1.4 Tabelat njoftuese

1.2. Dorëzimet tek Supervizori

1.2.1 Autorizimet me shkrim
1.2.2 Sigurimi i vizatimeve të detajeve
1.2.3 Dorëzimet tek supervizori
1.2.4 Shembuj
1.2.5 Vizatimet e punimeve të zbatuara

SEKSION 2
PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.1. Pastrimi i kantierit
2.1.1 Pastrimi I kantierit
2.1.2 Skarifikimi
2.1.3 Heqja e pëmëve dhe e shkurreve
2.1.4 Prishja e godinave, gardheve dhe strukturave
2.1.5 Mbrojtja e vëndit të pastruar

2.2. Punime prishjeje
2.2.1 Skeleritë
2.2.2 Supervizioni
2.2.3 Metoda dhe rradha e prishjes
2.2.4 Siguria në punë

2.3. Prishja e elementeve të godinës
2.3.1 Prishja e taracave
2.3.2 Prishja e mureve të gurit
2.3.3 Prishja e mureve të tullës
2.3.4 Prishja e dyshemeve
2.3.5 Prishja e veshjeve me pllaka të mureve
2.3.6 Heqja e dyerve dhe dritareve
2.3.7 Heqja e zgarave metalike

SEKSION 3
STRUKTURA E NDËRTIMIT

3.1. Mbulesat
3.1.1 Rikonstruksioni I tarracës
3.1.2 Tarraca të reja
3.1.3 Ulluqet vertikale dhë horizontale

SEKSION 4
FINITURAT

4.1. Rifiniturat e mureve
4.1.1 Suvatim i brendshëm në rikonstruksione
4.1.2 Suvatim i brendshëm në ndërtime të reja
4.1.3 Suvatim i jashtëm në rikonstruksione
4.1.4 Suvatim i jashtëm në ndërtime të reja
4.1.5 Lyerjë me bojë plastike në rikonstruksion
4.1.6 Lyerjë me bojë plastike në ndërtime të reja

SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Specifikime të përgjithshme

1.1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si "**.** ".

1.1.2 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, proçedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

1.1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.1.4 Tabelat njoftuese, etj.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

1.2 Dorëzimet te Supervizori

1.2.1 Autorizimet me shkrim

"Rregullat me shkrim " do t'i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuara, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Supervizorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.2.2 Dorëzimet tek supervizori

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave

Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

SEKSION 2

PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.1. Pastrimi i kantierit

2.1.1. Pastrimi i kantierit

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

2.1.2 Skarifikimi

Largime të mëdha me ekskavatorë dhe skarifikime, të kryera me dorë ose makinë nga terrene, nga çfarëdo lloj toke, qoftë edhe e ngurtë (terrene të ngurtë, rërë, zhavori, shkëmborë) duke përfshirë lëvizjen e rrënjëve, trungjeve, shkëmbinjve dhe materialeve me përmasa që nuk kalojnë 0,30 m3, duke përfshirë mbrojtjen e strukturave të nëndheshme si kanalizime uji, naftë ose gazi etj dhe duke përfshirë vendin e depozitimit të materialeve brenda në kantier ose largimin e tyre në rast nevoje.

2.1.3 Heqja e pemëve dhe shkurreve më të larta se 1.5m

Në përgjithësi duhet patur parasysh, që gjatë punimeve të pastrimit të mos dëmtohen ato pemë të cilat nuk pengojnë në rehabilitimin ose në ndërtimin e objektit të ri. Në rastet kur heqja e tyre është e domosdoshme, duhet të merren masa mbrojtëse në mënyrë që gjatë rrëzimit të tyre të mos dëmtohen personat dhe objektet përreth. Për këtë, për pemët që janë të larta mbi 10 m, duhet që prerja e tyre të bëhet me pjesë nga 3 m. Pjesa që pritet, duhet të lidhet me litar ose kavo dhe të tërhiqet nga ana ku sigurohet mbrojtja e personelit dhe e objekteve.

2.1.4 Prishja e godinave, gardheve dhe strukturave

Kontraktori duhet të heqë me kujdes vetëm ato ndërtime, gardhe, ose struktura të tjera të drejtuara nga Supervizori. Komponentët duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj. Komponentët të cilët sipas Supervizorit nuk janë të përshtatshëm për ripërdorim, duhen larguar, punë kjo që kryhet nga kontraktuesi. Materialet që janë të ripërdorshme do të

mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizen prej tij deri në përfundim të kontratës.
Kontraktori, duhet të paguajë çdo dëmtim të bërë gjatë transportit të materialeve me vlerë, të rrethimeve dhe struktuarave të tjera dhe nëse është e nevojshme duhet të paguajë kompensim.

2.1.5 Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave.

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.
Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji.
Kur përdoren mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatorë hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të bëhet kujdes, që pjesë të tyre të mos kenë kontakt me kabllo telefonik ose elektrik. Kontraktori duhet të informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që, ato të marrin masa për lëvizjen e kabllove.

2.1.6 Mbrojtja e vendit të pastruar

Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

2.2 PUNIME PRISHJEJE

2.2.1 Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.
Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim I objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eleminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.
Skeleri çeliku të tipit këmbalëc, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.
Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur , konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe

mbrojtjen me rrjetë.

2.2.2 Supervizioni

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

2.2.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.
Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.
Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementë çeliku dhe struktura betoni të forcuara do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave ne menyre qe te mos bien. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.
Në përgjithësi, puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të transportohen nga ashensorë, pastaj do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

2.2.4 Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet

b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperiencë

b) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmeta, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe bombola frymëmarrjeje.

2.3 Prishja e elementëve të godinës

2.3.1 Prishja e çative dhe e taracave

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla të tipit “Marsigliese” ose të tipit “Romana” (Vendi) dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë Trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, Trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontalë, ulluqët vertikalë dhe kapset përkatëse metalike që rezultojnë nga heqja

brenda ambientit të kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin dhe vënien mënjanë të tjegullave " Marsegliese" që do të ripërdoren, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes.
Shpërbërja e çatisë me tjegulla druri ose llamarinë të xinguar, me të njëjtat modalitete dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqeve horizontale, ulluqet vertikal dhe kapëset përkatëse metalike, kullezat e oxhakut, duke përfshirë skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes.
Heqja e tavanit të çfarëdo natyre, duke përfshirë strukturën mbajtëse, suvanë dhe impiantin elektrik që mund të ekzistojë; duke përfshirë ndër të tjera skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund heqjes së tavanit.
Prishje e Shtresës horizontale të hidro- izolimit të tarracës me zhvillime vertikale, edhe në praninë e oxhaqeve, e ndërtuar nga tre shtresa të mbivendosura letër katramaje, duke përfshirë heqjen e kapakëve të parapetit e të çdo pjese metalike dhe vënien mënjanë e spostimin në kantier të materialeve që formohen, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund plotësisht heqjes së tarracës.
Prishja e suvasë në sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të paktën 30 cm, deri në dalje në dukje të muraturës, për vendosjen e guainës.

2.3.2 Prishja e mureve të gurit

Prishje e plote ose e pjesshme e muraturës së gurit edhe nëse është e suvatuar, e çfarëdo forme ose trashësie, duke filluar nga lart poshtë, e kryer me çfarëdolloj mjeti (mekanizma, vegla) dhe çfarëdo lartësie ose thellësie, duke përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet të shkaktuara ndaj të tretëve. Ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujin, dritat etj...), si dhe vënien mënjanë dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

2.3.3 Prishja e mureve të tullës

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensioni, edhe e suvatuar ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdolloj mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujin, dritat etj..), si dhe vënien mënjanë dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

2.3.4 Prishja e dyshemeve

Prishja e dyshemeve të çfarëdo lloji dhe spostimin e materialeve, jashtë ambientit të kantierit

2.3.5 Prishja e veshjeve me pllaka të mureve

Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e Llaçit që ndodhet poshtë, pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

2.3.6 Heqja e dyerve dhe dritareve

Heqje dyersh dhe dritaresh, që realizohet para prishjes së murit, duke përfshirë kasën, telajot, etj Sistemimin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantiërit. dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier për ripërdorim.

2.3.7 Heqja e zgarave metalike

Heqja e zgarave të hekurit dhe sistemimin e materialit që rezulton, brenda ambientit të kantiërit, duke përfshirë përzgjedhjen e mundshme (të përcaktuar nga D.P.) dhe vënien mënjanë në një vend të caktuar të kantierit për ripërdorim.

SEKSIONI 3

3.1. MBULESAT

3.1.1 Rikonstruksioni i tarracës

Rikonstruksioni i dëmtimeve të pjesëve të pjerrëta, duke përdorur llaç çimento me përmbajtje për 1:2 sipas pikës 5.1.1.5, pas këtij riparimi do të formohet një shtresë llaç çimentoje me trashësi minimumi 2 cm të niveluar për krijimin e shtresës izoluese.
Punimi i sipërfaqeve vertikale i përgatitur për instalimin e membranave izoluese.
Shtresa izoluese duhet shtrirë në një sipërfaqe të thatë, të pastruar e niveluar mirë më parë me shtresë horizontale pjerrësi si dhe sipërfaqet vertikale. Këto trajtohen fillimisht me një shresë bituminoze, dhe mbi këto fillon vendosja e fletëve bituminoze, me fibër minerale, secila me trashësi 3 mm, të ngjitura me ngrohje dhe në mënyrë të tillë, që fletët t'i mbivendosen njëra - tjetrës, në sipërfaqe të pjerrëta ose vertikale, duke u siguruar që mbulesa e elementeve të bashkuara të jetë minimumi.10 cm.
Mbrojtja e membranës izoluese me plan vertikal ose të pjerrët do të realizohet me shtresë llaç ose plaka çimentoje me trashësi 3 cm (tipi i llaçit 1:2), pllakat ose shtresa e llaçit do të realizohet në formë kuadrati 2 x 2 m, me fuga nga 2 cm, të cilat do të mbushen me bitum, sipas kërkesave të dhëna në vizatime.
Izolimi i sipërfaqeve vertikale bëhet, në mënyrë që të mbrohen nga dëmtimi i instalimeve të membranave të reja izoluese.
Zëvendësimi i parapeteve të hequra, duke përfshirë riparime të nevojshme e zëvendësim me pllaka të reja duke i fiksuar me llaç me çimento (tip 1:2) të ngjitura dhe të gjitha kërkesat që tarracat të riparohen me cilësi.

3.1.2 Taraca të reja

Termoizolimi

Termoizolimi realizohet duke përdorur materiale termoizoluese (penobeton ose

polisterol) të vendosura në formë të pjerrët në zonat e shtresave hidroizoluese.

Mbulimi me shtresa llaçi i pjerrësisë së kërkuar me një minimim trashësie prej 3 cm, e realizuar me llaç çimento (tipi 1:2), e niveluar për instalimin e shtresës izoluese.
Hidroizolimi
Hidroizolimi duhet shtrirë në një sipërfaqë të thatë, të niveluar më parë, duke përfshirë sipërfaqe vertikale, të trajtuara me shtresë të parë bituminoze si veshje e parë. Mbi këtë vendosen dy fletë bituminoze, me fibër minerale, secila me trashësi min. 3 mm, e ngjitur me flakë, me membrana të vendosura në këndet e duhura mbi njëra - tjetrën, në sipërfaqe të pjerrëta ose vertikale, duke u siguruar se mbulesa e elementeve të bashkuara të jetë 12 cm.
Mbrojtja e membranës izoluese me plan vertikal ose të pjerrët do të realizohet me shtresë llaç ose plaka çimentoje me trashësi 3 cm (tipi i llaçit 1:2), pllakat ose shtresa e llaçit do të realizohet në formë kuadrati 2 x 2 m, me fuga nga 2 cm, të cilat do të mbushen me bitum sipas kërkesave të dhëna në vizatime.

Instalimi i parapeteve betoni me kanale kulluese të inkorporuara, në beton të forcuara, të parafabrikuara ose të derdhura në vend sipas të dhënave në skica, beton (tipi 200) në dozim m^3 siç është treguar në 4.1.4, duke përfshirë kallëpet në përputhje me të gjitha kërkesat për të siguruar tarracën, me një punë me cilësi.

Në rastet kur hidroizolimi i taracës bëhet kur nuk ka llustër çimentoje mbi shtresat e katramave, atëherë vendoset një shtresë prej 5 cm, me zhavor të rrumbullakët me dimension 32 mm –64 mm, e cila shërben për mbrojtjen e katramasë.

3.1.3 Ulluqet vertikale dhe horizontale

Ulluqet horizontale
Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale prodhohen me material plastik ose me llamarinë xingato. Ulluku me llamarinë prej çeliku të xinguar me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm. Në objektet me taracë përdoren edhe ulluqe betoni. Të gjtha ulluqet prej betoni duhet të hidroizolohen me guaino nga ana e brendshme e tyre. Ulluket e vendosura ndërmjet çatise dhe parapetit do të jenë prej llamarine të xinguar, sipas detajeve të vizatimit.
Ulluqet vertikale
Janë për shkarkimin e ujrave të çative dhe taracave, dhe kur janë në gjendje jo të mirë duhet të çmontohen dhe të zëvendësohen me ullukë të rinj.
Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të çative dhe tarracave që përgatiten me llamarinë prej çeliku të xinguar, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm, kurse ulluqet vertikale prej PVC kanë dimensione nga 8 deri në 12 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe çatie nga 30 deri në 60 m^2.
Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrat e një sipërfaqe çatie ose tarace jo më të madhe se 60 m^2.

Ulukët duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës, me anë të qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuar çdo 2 m. Ujrat e taracës që do të kalojnë në tubat vertikale duhet të mblidhen nëpërmjet një pjate prej llamarine të xinguar, i riveshur me guainë të vendosur në flakë, me trashësi 3 mm, të vendosur në mënyrë të tërthortë, ndërmjet muraturës dhe parapetit, me pjerrësi 1%, e cila lidhet me kasetën e shkarkimit sipas udhëzimeve në projekt.

Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m, duhet të jetë PVC dhe e mbërthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehet me bërryl 90 gradë.

SEKSIONI 4

RIFINITURAT

4.1. Rifiniturat e mureve

4.1.1 Suvatimi i brendshëm në rikonstruksione

Sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë.

Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1 : 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

4.1.2 Suvatim i brendshëm në ndërtime të reja

Sprucim i mureve dhe tavaneve me llaç çimentoje të lëngët, për përmirësimin e ngjitjës së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1: 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

4.1.3 Suvatim i jashtëm në rikonstruksione

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë.

